



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 71 datë 01.07 2026

PËR DHËNIE TITULLI “ QYTETAR NDERI I PËRMETIT”

Në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 54 pika m,Neni 55 e në vijim, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,Vendimi Nr.33 datë 22.01.2026 i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, Ligji Nr.94/2022 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë,nenet 8 e në vijim, si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” Këshilli Bashkiak me propozim të Shoqatës “Dëshnica”,

VENDOSI:

1 – T”i japë titullin “Qytetar Nderi i Përmetit” Z .Et’hem Bejo, me motivacionin :

“Me vlerësim të lartë për kontribut të jashtëzakonshëm dhe shumëvjeçar në fushën e edukimit fizik dhe sportit,për përkushtimin e palodhur në formimin e brezave të rinj si dhe për rolin e tij të rëndësishëm në promovimin e vlerave sportive,edukative dhe qytetare duke shërbyer si model frymëzimi për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”.

2 - Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55 pika 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Aleks TANE

Në mungesë dhe me porosi

Nënkryetari i Këshillit të Bashkisë Përmet

Agim ANDONI

